




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Komuna Drenas
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

02 Nr. 400-24491 Dt. 07.07.2020

Shkresë	07.07.2020
Nga:	ZPP BLERIM NIKA 
Te:	Zyra e Prokurimit
Lënda:	Vendim



Është dërguar një kërkesë për rishqyrtim në E-prokurim për projektin me nr të prokurimit 611-20-058-521, “Rregullimi i Infrastrukturës, trotuar dhe ndriqim publik në Komunën e Drenasit”

1. Nuk është respektuar Neni 1 pika 1 e LPP-së (Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, me transparent dhe më të drejtë shfrytëzimi të fondeve publike).
2. Nuk është respektuar Neni 7 pika 1 i LPP-së (Barazia dhe Trajtimi, Autoritei kontraktues do t’i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barbartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente)
3. Nuk është respektuar Neni 51 pika 3 i LPP-së, citojmë “Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale në raport me lënden e kontratës përkatëse”.
4. Nuk janë respektuar: Njoftimin e KRPP-së të datave 22 nëntor 2019 rreth mos kërkesave të ISO pa pasur nevojë, pa qenë në harmoni me natyrën e projektit dhe të

datës 21 prill 2020 rreth moskërkesave për a) STANDARDE ENC – Kërkesa nr4, Standardi EN-60598-2-3,-b) Nr.5 STANDARDI EN 62722-2-1 2014 nuk është e nevojshme të kërkohen për arsye se në këtë rast po favorizohet një prodhues dhe një tenderues. Në paramasën kemi shifër tjetër të EN STANDARDIT En 55015, për të cilat lehtë mund të verifikohet se për cilin prodhues dhe për cilin ofertues.

5. Në paramasë mirë ceken vetitë e trupit ndriçues: *Mbrojtje Mekanike; IP65 (IP66)

*Qëndrueshmëri pune:>100 000(h) *Efikasitetet të ndriçueshmërisë së ngjyrës >160lm/Ë

*Në 100 000 (*h/punë) të LED-it:L70/B20 *Temperaturë të ngjyrës:<5000K
*Tension Pune:90....270V(50Hz) *Faktor të fuqisë:>0.92 *Temperaturë pune(-40...+60)°C *Mbrojtje në goditje:IK10 *Garancioni:> 5vite

Këto janë karakteristikat e trupit ndriçues që AK ka drejtë t'i kërkoj, ndërsa shifrat e emnune janë vetëm për një prodhues, sepse çdo numër në EN përcakton një veçori të trupit ndriçues, formen e jashtme, vetitë mekanike, elektrike etj. Duke ju referuar këtyre standardeve me këto shifra, AK ka dëshmi e ky lloj i trupave ndriçues është kualitet apo trupa ndriçues më të mirë ndaj prodhuesve tjerë.

ARGUMENTET TONA

6. Në paramasë mirë ceken vetitë e trupit ndriçues: *Mbrojtje mekanike-IP65 (IP66), *Qëndrueshmëri pune:>100 000 (h) *Efikasitet të ndriçueshmërisë:160lm/Ë *Në 100 000 (h/punë) të LED-it:L70/B20, *Temperaturë të ngjyrës:<5000K * Tension Pune:90....270 V (50Hz) *Faktor të fuqisë:>0.92 n*Temperaturë pune(-40...+60)°C *Mbrojtje në goditje:IK10 *Garancioni:>5vite. Në bazë të kësaj kërkesë në paramasë për karakteristikat e trupave ndriçues i bashkangjitet katalogut dhe çertifikata.

PERGJIGJE NGA AK :

AK Komuna e Drenasit e ka vlerësuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim në lidhje me këtë procedurë të prokurimit. Të gjitha kërkesat në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit janë konform Ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës. Po ashtu, është e drejtë e secilit OE për rishqyrtim në lidhje me paqartësitë e njoftimit për

kontratë dhe dosjes së tenderit. Njoftimi për kontratë është konform Ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, duke mos diskriminuar asnjë OE .

Të dyja standartet janë kërkuar për kualitet sa me të lartë të dritave, prandaj vendimi i KRPP- së, 88/2019 i datës 22.11.2019, nuk potencon që të mos kërkohen fare ISO – Standardet, por të specifikohen në lidhje me projektin. Ndërsa, njoftimi me nr 47/2020 i datës 12.06.2020, shfuqizon Njoftimet me Nr.40/2020, 41/2020, 42/2020 të datës 21.04.2020 të cilat kanë pasur për qëllim lehtësimin e procedurave të tenderimit në situatën e krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19.

Kërkesa për ISO Standarte është kërkuar, sepse EN 62722-2-1 - ky standart i plotëson kërkesën tonë në AK për drita me performancë më të mirë. Projekti jonë është paraparë të furnizohet me këtë lloj materiali, në këto pozicione pasi i plotëson kushtet e qendrueshmerisë dhe kanë kualitete më të lartë. Cdo prodhues/tenderues që ka këtë lloj Iso të plotësuar ka të drejtë të tenderoj.

En 62722-2-1 - Lumiance performance- Performanca e lumenave (ky lloj i standartit tregon se materiali shpenzon me pak energji elektrike, ndërsa zëvendëson /jep ndriqim më të lartë.

EN 55015- Limits and methods of measurement of radio disturbance characteristics of electrical lighting and similar equipment- ky lloj standarti tregon se materiali nuk bënë pengimi i sinjaleve radiofonike, d.m.th nëse drita nuk e posedon këtë lloj standarti atëherë sinjalet radiofonike si psh internet, kabllovit kanë pengesa në transmetim.

E drejtë e çdo OE pjesëmarrës mund që të vazhdoj me tutje me kërkesat ankimore.